

PËRMBLEDHJE PËR PROJEKTIN

Emri i projektit	Parandalimi i propagandës së huaj dhe rrezikut të dezinformimit duke forcuar kapacitetet e medieve dhe gazetarëve
E mbështetur nga	Ambasada e SHBA-së në Maqedoninë e Veriut
Programi	US GRANTS PROGRAM APPLICATION
Roli i SHGM-së	Bashkëpunëtor i projektit
Buxheti total	\$24 000
Granti nga donatori:	\$24 000
Periudha e realizimit	06.01.2023 – 31.03.2024
Territori i realizimit	Maqedonia e Veriut
Për projektin	Përmbledhje
Konteksti	Lufta kundër dezinformatave të huaja, propagandës dhe ndikimit të regjimeve autoritare që duan të minojnë demokracinë dhe lirinë e shprehjes janë pjesë e misionit bazë të ESTIMA-së dhe SHGM-së. Në këtë kontekst, në nivelin e parë - mikro, aktivitetet e planifikuara dhe të ndërmarra në këtë projekt do të forcojnë kapacitetet e të dyja organizatave për t'u angazhuar në projekte dhe iniciativa të reja në këtë fushë, dhe për t'i mbajtur këto çështje në agjendën e politikë-bërësve, donatorëve, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të prekura. Në një nivel më të gjerë, kapaciteti i ndërtuar në mesin e gazetarëve do të mbetet përtej kohëzgjatjes së projektit, pasi gazetarët e përfshirë në projekt do të fitojnë njohuri dhe kontakte që mund t'i përdorin në të ardhmen, si dhe do t'ua përcjellin kolegëve të tyre në mediet ku punojnë.
Qëllimi	Ky projekt synon të mbështesë mediet dhe gazetarët që të merren me dezinformatat që vijnë nga jashtë, të ndihmojë në mbrojtjen e hapësirës mediatike maqedonase nga propaganda negative, dhe të paraqesë përmbajtje dhe kundër-narrativa të besueshme dhe objektive që mund t'i ndihmojnë qytetarët të formojnë një opinion të bazuar mbi informacione të sakta.
Grupe caku	Gazetarët dhe mediet
Rezultatet e pritshme	Forcimi i kapaciteteve të gazetarëve për të fituar aftësi për trajtimin e dezinformatave dhe njohjen e tyre, d.m.th. përmes ndërgjegjësimit të gazetarëve dhe medieve për këtë temë, do të ndikohet pozitivisht në ndërgjegjësimin e qytetarëve.
Aktivitete mbështetëse të projektit	- Një sërë aktivitetsesh që kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin, ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të gazetarëve - Mësimi nëpërmjet praktikës se si të zhvillohen përmbajtje mediatike objektive dhe të argumentuara mirë për të ekspozuar propagandën ruse dhe kineze dhe për të ofruar burime alternative dhe të besueshme informacioni. - Inkurajimi i diskutimit mes komunitetit gazetaresk për sfidat me të cilat përballen në këtë temë

Logo e donatorit		Estima	
------------------	---	--------	--